



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë më, 11.03.2019, ora 11.50

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i projektligjit "Për ratifikimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për projektin "Siguria e digave", të ratifikuar me ligjin nr. 9965.

2. Shqyrtimi i projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2017, për projektin "Programi për rinovimin e konvikteve në Kampusin Universitar të Tiranës, sipas parimit të eficiencës energjetike, faza III".

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Anastas Angjeli, Antoneta Dhima, Ervin Bushati, Evis Kushi, Roland Xhelilaj, Vullnet Sinaj, Senida Mesi, Ismet Beqiraj, Ilir Xhakolli, Xhevit Bushaj dhe Reme Lala.

Mungon:

Blerina Gjylameti

Të ftuar:

Ilir Bejtja –Zëvendësministër në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Agim Bregasi - Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Alfred Bundo - Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj – Fillojmë mbledhjen.

Në rendin e ditës së sotme kemi dy projektligje.

E para, është projektligji "Për ratifikimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për projektin "Siguria e digave", të ratifikuar me ligjin nr. 9965", një ligj i prekur disa herë për shkak të vonesave në asimilimin e fondeve. Megjithatë, besoj se do të jetë shumë e shpejtë, nuk ka nevojë për shumë minuta, sepse është procedurë për shtyrje afati.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Urdhëroni?

Të mbaroj unë, Ilir.

E dyta, shqyrtimi i projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2017, për projektin "Programi për rinovimin e konvikteve në Kampusin Universitar të Tiranës, sipas parimit të eficiencës energjetike, faza III".

Mendoj të fillojmë menjëherë me projektligjin e parë dhe më pas të vazhdojmë me ratifikimin e marrëveshjes ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mendon të bëjmë të kundërtën? Pse, Ilir?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk kishe gjë?

Fillojmë me sigurinë e digave.

Ftoj relatuesen të flasë.

Senida, je relatuese për këtë, apo jo?

Ju lutem, fillojmë me sigurinë e digave dhe kalojmë te Këshilli Kombëtar.

Senida Mesi – Përsëndetje, të gjithëve!

Sot kemi diskutimin e projektligjit "Për ratifikimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për projektin "Siguria e digave", të ratifikuar me ligjin nr. 9965", datë 24.7.2008"

Ky projektligj vjen i propozuar nga Këshilli i Ministrave në përputhje të plotë me nene të veçanta, sikurse e keni edhe në projektpropozimin nr. 7883, pika 1, neni 21 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Qëllimi i projektligjit është ratifikimi i letërmarrëveshjes, e cila

do të kontribuojë, së pari, në sigurinë e digave më të mëdha hidroelektrike mbi kaskadën e lumenjve Drin dhe Mat në territorin e Shqipërisë.

Objektivi i dytë është përmirësimi i eficiencës operative të digave hidroelektrike dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë së furnizimit me energji në tregun rajonal.

Ky projekt përbën fazën e pestë të programit dhe përbëhet me pjesët e mëposhtme.

E para, ka të bëjë me investime infrastrukturore të sigurisë së digave dhe kryesisht mbi lumin Drin dhe Mat në digën e Fierzës, në digën e Vaut të Dejës dhe hidrocentralin e Komanit.

E dyta, ka të bëjë me asistencën teknike dhe trajtimin për sigurinë e digave për mosofrimin e shërbimeve të trajnimit.

Aktualisht, fondet, që kalojnë nga kategoria 3 në kategorinë 2, me qëllim mbulimin e kostove për supervizimin e punimeve dhe financimit, në panelin e pavarur të ekspertëve për projektin e sigurisë së digave janë fonde të paangazhuara, që do të thotë se nuk do të ndikojnë në ecurinë e projektit. Për zbatimin e kësaj marrëveshjeje në tërësi është përgjegjëse Korporata Elektroenergjetike Shqiptare dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sikurse edhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Projekti është pjesë e parashikimeve buxhetore të KESH-it për periudhën 2018-2020. Sigurisht, është një projektligj shumë i rëndësishëm për ministrinë, për Këshillin e Ministrave dhe për sistemin elektroenergjetik, ndaj ju ftoj ta miratojmë.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj - Faleminderit!

Zoti Zëvendësministër, urdhëroni!

Ilir Bejtja – Siç e tha edhe zonja Mesi, bëhet fjalë për një rialokim nga objektivi dy në tre, nga fondet që kemi pasur të paalokuara nga kredia, në kredinë e re që është miratuar po nga ju para një viti për sigurinë e digave, ku ne nuk kemi parashikuar fond për supervizimin, pasi i kishim, sepse trashëgojen. Pra, janë 300 mijë euro, të cilat kalojnë dhe u shtyhet edhe afati për përdorim.

Arben Ahmetaj – Unë kam vetëm një pyetje, sepse kjo është temë e njohur, që ka ardhur disa herë në komision. Kur mbaron ky projekt, zoti Bejtja?

Ilir Bejtja – Projekti që ne kemi aplikuar në fillim me marrëveshjen me Bankën Botërore përfshin të gjitha digat, Vau i Dejës ...

Arben Ahmetaj – Jam shumë i qartë, sepse e kam negociuar disa herë vet. Të lutem, më thuaj, kur mbaron?

Ilir Bejtja – Kur të harxhojmë 150 milionë.

Arben Ahmetaj – Kur?

Ilir Bejtja – Kur t’i harxhojmë të gjitha.

Arben Ahmetaj – Kur? Deri tani vini me shtyrje.

Ilir Bejtja – Është proces, nuk mund t’ju them dot kur.

Sapo kemi filluar në Fier dhe ...

Arben Ahmetaj – Nuk bëni planifikim ju në qeveri, zoti Ilir?

Ilir Bejtja – Kemi bërë, por lidhet edhe me prodhimin. Ne nuk mund t’i mbylлим ...

Arben Ahmetaj – Ju keni çdo vit planifikim për prodhimin.

Ilir Bejtja – Po. Çdo vit ne kemi një kredi ...

Arben Ahmetaj – Keni planifikim për prodhimin?

Ilir Bejtja – Po.

Arben Ahmetaj – Keni planifikim kur mbaron ky projekt?

Ilir Bejtja – Nuk mund t’jua them tani.

Arben Ahmetaj – Faleminderit për sqarimin!

Na dërgo me shkrim planin që keni për këtë projekt, po pate mundësi!

Ilir Bejtja – Po.

Arben Ahmetaj – Është shumë e përgjegjshme nga ana e ministrisë suaj.

Ilir Bejtja – Kështu ka qenë edhe më parë.

Arben Ahmetaj – Jo, nuk ka qenë asnjëherë kështu.

Ka pyetje apo komente? Nuk ka.

Kalojmë në votim.

Më thotë shërbimi mbështetës i komisionit që në nenin 2 fjala “vendim” zëvendësohet me fjalën “ligj”. Keni të njëjtin defekt në komision, sillni ligje, por i quani “vendime”.

Faleminderit, zoti Zëvendësministër!

Kalojmë në votimin në parim. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2, me ndryshimin që referova. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Faleminderit!

(Ndërrhyrje pa mikrofon.)

Po.

Faleminderit për korrigjimin që më bëni për procedurën!

Kalojmë në votimin në tërësi. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Të bëhet gati për seancën e ardhshme.

Faleminderit!

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë më, 11.3.2019, ora 11.50

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – ryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2017, për projektin "Programi për rinovimin e konvikteve në Kampusin Universitar të Tiranës, sipas parimit të eficiencës energjetike, faza III".

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Anastas Angjeli, Antoneta Dhima, Ervin Bushati, Evis Kushi, Roland Xhelilaj, Vullnet Sinaj, Senida Mesi, Pjerin Ndreu, Ilir Xhakolli, Xhevit Bushaj dhe Reme Lala.

Mungon:

Blerina Gjylameti

Të ftuar:

Ilir Bejtja - Zëvendësministër në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Agim Bregasi - Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Alfred Bundo - Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Arben Ahmetaj - Kalojmë te projektligji i dytë.

Do të bëj një relativim shumë të shpejtë për këtë projektligj.

Për sa i përket ratifikimit të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, praktikisht është një projektligj shumë i rëndësishëm, një proces ratifikimi shumë i rëndësishëm, që ka të bëjë me vëmendjen e qeverisë dhe të kësaj maxhorance për sa u përket përmirësimit të kushteve të konvikteve universitare.

E gjithë kjo paketë jo rastësisht është pjesë edhe e “Paktit të universitetit”, paktit të qeverisë me universitetet, që në themel ka të bëjë me uljen e kostove për studentët, siç ishte rasti i drejtpërdrejtë i subvencionimit të tarifave me reflektim ulje për atë që do të paguajnë studentët, si dhe projektet e rëndësishme infrastrukturore, që kanë të bëjnë me përmirësimin e kushteve të konvikteve. Ka qenë faza e parë, faza e dytë, faza e tretë dhe, siç e dini, qeveria ka iniciuar një proces negocimi me KfW-në për një kredi të butë, rreth 18 euro, plus 7 milionë euro grant për të njëjtin objekt. Ajo që qeveria premtoi gjatë muajit dhjetor, sot është e realizuar, tarifat për universitetet janë ulur me 50% për të gjithë studentët dhe për studentët e ekselencës janë praktikisht 100%. Janë mbi 6 mijë e 300 familje në nevojë që nuk paguajnë për fëmijët e tyre tarifë universitare dhe ndërkohë, për të dyja kategoritë, qoftë për ekselencën dhe studentët që vijnë nga familje në nevojë, është akorduar bursë e rritur nga 8900 lekë në muaj, në 10.000 lekë në muaj. Pra, përveç se është rritur numri, është rritur edhe shuma e përfitimit.

Ndërkohë, ka një komunikim intensiv midis qeverisë dhe universiteteve për vazhdimin e dialogut me studentët dhe me pedagogët për përmirësimin e kushteve dhe besoj se ky ratifikim është një nga shembujt më të drejtpërdrejtë që duhet ta rakordojmë historikisht. U bënë 30 vjet që në ato konvikte nuk vihej dorë. Ka qenë kjo maxhorancë, ka qenë iniciativë e kancelares Merkel, me kërkesë të Kryeministrit, zotit Rama, për grantin e parë dhe vazhdojmë me grantin e dytë dhe më pas me projektin e kredisë, për të cilën dot fillojnë negociatat.

Në të njëjtën kohë, qeveria akordoi në fund të dhjetorit, nëpërmjet ndryshimeve në buxhet, edhe një shumë prej 300 milionë lekësh për Bashkinë e Tiranës me objekt të dominuar përmirësimin e infrastrukturës në konvikte dhe, në dijeninë time, kryetari i Bashkisë së Tiranës ka filluar punën me shpejtësi për rehabilitimin e pesë godinave.

Zoti Zëvendësministër, nuk besoj se ju keni ndonjë shtesë në lidhje me këtë, por, nëse keni, është kënaqësi ta ndani me ne.

Ilir Bejtja – Për të shtuar pak informacion, projekti ka filluar me restaurimin e katër godinave të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, në të cilat kemi akomoduar rreth 580 studentë, ku thelbi nuk ka qenë vetëm përmirësimi i performancës energjetike, siç thatë edhe ju, por edhe përmirësimi i kushteve të jetesës për studentët në dhoma dyshe, treshe ose miniapartamente, të cilat kanë edhe mjediset e shërbimit brenda tyre. Në projektin e dytë do të përfitojnë 1 mijë e 800 studentë dhe do të rehabilitohen plot 9 godina. Pra, numri total i godinave arrin në 13 dhe do të bëhet edhe auditimi i 24 godinave të mbetura po me këtë grant, bashkë me 125 mijë eurot, të cilat janë vënë për vlerësimin, auditimin e tyre nga KfW-ja. Menjëherë pas auditimit, siç thatë edhe ju, do të fillojë projekti për rehabilitimin dhe restaurimin e 24 godinave të mbetura. I gjithë projekti në total shkon rreth 35 milionë euro, 18 milionë euro janë kredi dhe pjesa tjetër është grant nga qeveria gjermane dhe KfW-ja.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Ka pyetje apo komente?

Ismet Beqiraj – Mos u mërzit, zoti Arben!

Arben Ahmetaj – Është kënaqësi që ju vazhdimisht bëni komente të vlefshme për çdo ligj.

Ismet Beqiraj – Po, sigurisht, unë do të bëj komente, sepse edhe për mua është shumë kënaqësi që ne sot bëjmë ratifikimin e kësaj marrëveshjeje, që është në shërbim të “Paktit për universitetin”, një fjalë jo vetëm e thënë, por e mbajtur, ku si qëllim kryesor ka përmirësimin e komfortit në përgjithësi të jetës studentore, që ka qenë edhe një nga problemet që dolën edhe në evidencë të protestës studentore, ku fjalët e dhëna të programuara, po jetëzohen. Projekti që u tha në fillim nuk ka mbetur thjesht në letër, sikurse sot aktualisht goditet kjo platformë serioze që qeveria e kësaj maxhorance ka marrë përsipër.

Në vijim, për mua, përveç benefiteve të tjera që sjell, do të më interesonte t’ju bëja disa pyetje përfaqësuesve të ministrisë, ku përveç komfortit, në parim, kjo marrëveshje ka edhe eficiencën e energjisë dhe synohet edhe reduktimi i përgjithshëm i energjisë në 75 kilovatë orë për metër katror në vit, besoj. Ju lutem, a ka ndonjë studim sa është kostoja e përgjithshme e energjisë aktualisht, që të shikojmë diferencën e këtij treguesi performance, i cili përputhet edhe me kërkesat e standardit europian.

Nga ana tjetër, një benefit nga ky investim është edhe llogaritja e reduktimit të karbonit. Nga ministria, nëpërmjet institucioneve përkatëse të fushës së mbrojtjes së mjedisit, a ka ndonjë studim që e bashkëshoqëron, që të jetë i prekshëm edhe për atë që dëgjon publiku, që realisht në konceptin tim, edhe inxhinierik, unë e kuptoj, por jo vetëm për banorët e këtij qyteti, por edhe për publikun në përgjithësi?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Ju lutem, zoti Zëvendësministër!

Ilir Bejtja – Po i japim për shembull atë që kemi ndërtuar në godinat e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, ku kursehet 20% e konsumit të energjisë aktuale. Parashikohet që investimi i ri të paguhet vetëm nga kursimi i energjisë. Ky është projeksioni që kemi si target. Ndërkohë, për dimensionin e karbonit, në dijeninë tonë, ndërmarrja e Qytetit Studenti përdor për ngrohjen e ujit edhe naftë apo të tjera lind djegëse, duke e ndotur mjedisin përreth. Nuk mund t'ju them ekzaktesisht sa është dimensionin e karbonit që ato kanë sot, por këtu reduktohet totalisht djegia e fosileve, e karburanteve për ngrohjen e ujit, sepse parashikohet të jetë me energji të rinovueshme dhe panele diellore. Atë që kanë sot nuk duhet ta kenë si ndotje nesër.

Ismet Beqiraj – Faleminderit!

Te marrëveshja që është bërë, që kemi përpara, te pika 2 e nenit 2 të saj thuhet se premtimi i shumës së përmendur në nenin 1 të paragrafit 1 do të zhvleftësohet në rast se kontrata përkatëse e financimit nuk lidhet deri më 31 dhjetor 2018. Mos jemi me vonesë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Arben Ahmetaj – Ka një shtyrje në fillim të nëntorit, po në parlament, për këtë marrëveshje.

Megjithatë, është e rëndësishme që komisioni ta dinte me saktësi.

Faleminderit, zoti Vullnet!

Ka pyetje apo komente të tjera? Nuk ka.

Kalojmë në votimin në parim. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Të bëhet gati për ditën e mërkurë për në parlament.

Faleminderit komisionit dhe ministrisë!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti